

COLLECTING ARMS ACTION ON GJAKOVA TERRITORY (1955-1956) AKSIONI I MBLEDHJES SË ARMËVE NË GJAKOVË ME RRETHINË (1955-1956)

SHEFQET DINAJ
Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, KOSOVË
Email: Profi-96@hotmail.com

AKTET VI, 5: 552 - 556, 2012

PERMBLEDHJE

Pushteti serb i instaluar në Kosovë përdori forma të shumta të ushtrimit të dhunës dhe të represionit ndaj shqiptarëve. Për të shkruar këtë punim, i cili mendoj se është me rëndësi, më kanë nxitur shumë faktorë. Së pari puna ime këmbëngulëse në hulumtimin e burimeve të pa publikuara deri më sot, të cilat i gjeta në Arkivin Historik Regjional të Gjakovës. Një ndër format ishte shpërngulja më dhunë për në Turqi, e cila mori përmasa shqetësuese, sidomos pas aksionit të mbledhjes së armëve, që u zbatua në dimrin e viteve 1955-56. Nga fillimi i viteve '50 e deri nga mesi i viteve '60, nga represioni i shtetit jugosllav, u shpërngulen për në Turqi dhjetëra mijëra shqiptarë. Formë tjetër e dhunës dhe e terrorit ishte edhe rekuizimi dhe shtetëzimi (nacionalizimi) i pronës së shqiptarëve. Në këtë studim jam fokusuar në temën e mbledhjes së armëve në një rajon të kufizuar (në Gjakovë) me rrethinë dhe në një kohë, po ashtu të kufizuar (1955-1956)..

Fjalët kyçe: aksion, armë, presion, grikësim, shprengulje.

SUMMARY

Serbian occupation installed in Kosovo had multiple forms of violence and repression to Albanians. To write this proceeding which I think is important, I was urged by many factors. Firstly my insistent job on researching the unpublished sources till today that I found at Regional Historical Archive in Gjakova. One of ways they used it was the violence displacement to Turkey, which took worrying dimensions after the action of collecting arms, which were executed in winter of the years 1955-56. By the beginning of the year '50 till the middle of the year '60, from the repression of Yugoslavia were displaced thousands of Albanian to Turkey. Another form of violence and terror was also the requisitioning and nationalization of Albanian ownership. In this study I focused on the theme of collecting weapons in a limited area (in Gjakova) with the surroundings and at one time also limited (1955-1956), because I think that would be fair and objective.

Key words: action, arms, presion, scare, displacement.

Hyrje

I ashtuquajturi "Aksion i mbledhjes së armëve në vitet 1955-1956" është ndër format më të vrazhda të presionit, i cili u zbatua nga regjimi komunist jugosllav ndaj shqiptarëve të pambrojtur, kryesisht në pjesët rurale të Kosovës, me qëllim të krijimit të atmosferës së frikës e paperspektivës për të ardhmen. Krejt kjo në funksion të shpënguljes së tyre dhe të spastrimit etnik të Kosovës e të trojeve të tjera shqiptare në kuadër të Jugosllavisë. Për tematikën që në

trajtoj, sillen prurjet e deritanishme të literaturës historike dhe sidomos burime të papublikuara deri më sot, të cilat i kam gjetur gjatë hulumtimeve të mija në Arkivin e Agjensisë Shtetërore të Kosovës (ASHAK) në Prishtinë dhe në Arkivin Historik Regjional të Gjakovës (AHRGJ). Gjithashtu kam shfrytëzuar artikujt e gazetës *Rilindja* të vitit 1966, e cila pas Brionëve dhe rënies së Rankoviqit u dallua për demaskimin e deformimeve dhe keqtrajtimeve të bëra nga organet e Sigurimit Shtetëror. Kjo, sepse shtypi

nëpërmjet dëshmime të protagonistëve të kohës, mbuloi atë boshllëk që ishte krijuar nga heshtja që ai kishte mbajtur gjatë viteve 1955-1956, kur kryhej aksioni i mbledhjes së armëve. Përsa i përket literaturës shkencore për temën që unë trajtoj, ajo ka qenë relativisht e pakët. Sidoqoftë, intervistat dhe këshillimet e shumta që unë kam pasur me viktima dhe dëshmitarë të asaj kohe, më kanë dhënë një ndihmesë të madhe, si në aspektin profesional, ashtu edhe në atë moral, pasi ato i dhanë frymëmarrje dhe ndjeshmëri kumtesës sime.

Qëllimi i aksionit të mbledhjes së armëve

Aksioni i armëve filloi në dimrin e vitit 1955 dhe vazhdoi deri në pranverë të vitit 1956. Ai ishte pjesë përbërëse e platformës për dhunimin e dëbimin e shqiptarëve nga trojet e tyre. Duke qenë se kjo platformë nuk ishte e lehtë për t'u realizuar ndër shqiptarët, të cilët për kurajot civile e ndjenja të forta kombëtare, e donin Kosovën dhe ishin të gatshëm të sakrifikonin dhe jetën për të qarqet nacionaliste serbe fabrikuan shpifjet dhe përdorën dhunën për të krijuar *ankth, frikë e pasiguri të përhershme te popullsia shqiptare e Kosovës*. Thashethemet se “shqiptarët po përgatiteshin për një kryengritje të madhe për t'u bashkuar me Shqipërinë” u shndërruan në një akuzë shtetërore ndaj shtetasve jugosllavë me kombësi shqiptare në Kosovë.

U deklarua zyrtarisht se Kosova ishte “një ndër rajonet më të rrezikshme në vend”, ku “përgatitej puçi” dhe prandaj “duhej të çarmatosej armiku” (*Rilindja*, 19 maj 1966, 16 tetor 1966, 16 shtator 1966). E që akuza të bëhej më e besueshme për opinionin publik, në shënjestër u vunë shqiptarët e atyre krahinave që ishin shquar për ndjenjat e tyre patriotike e për qëndresë ndaj regjimit komunist serb e ndaj pushuesve të huaj. Nuk është e rastit që fillimisht aksioni i mbledhjes së armëve nisi në malësinë e Rugovës dhe u shtri në rajonet e spikatura për qëndresë kundër dhunës serbe, si në Smirë, Logjë, Vrellë, Rakoshë, Suharekë, Sërbicë, Krushë, Kllokot, Shalë (AHRGj 1966: 23).

Një qëllim tjetër i Aksionit të mbledhjes së armëve ishte *nxitja e shovinizmit etnik në Kosovë*.

Duke i paraqitur shqiptarët si një popullsi e rrezikshme, nxitej te serbët e malazezët në Kosovë urrejtja ndaj shqiptarëve dhe frika ndaj tyre.

Së fundmi, por jo së paku, shqiptarët e keq-trajtuar apo të tjerë që ishin dëshmitarë të ngjarjeve dhe atmosferës së rënduar e armiqësore të *detyroheshin të largoheshin nga Kosova*. Pikërisht ky ishte qëllimi final i Aksionit të mbledhjes së armëve.

Organizatorët e metodat e përdorura gjatë Aksionit të mbledhjes së armëve

Aksioni i mbledhjes së armëve është nxitur, organizuar e zbatuar nga ana e Shërbimit të Sigurimit Shtetëror në Krahinë me dijeninë dhe pëlqimin e organeve republikane federative të sigurimit shtetëror, por deri në njëfarë shkalle edhe të strukturave të larta politike, të cilat janë mbajtur në informim të vazhdueshëm e të plotë. Fillimisht eksponentë të Shërbimit të Sigurimit Shtetëror mbajtën mbledhje me të gjithë komandantët e policisë së komunës së Gjakovës, siç ishin Mirk Iliqi, Milaim Gazetoviçi; me policët dhe punonjësit operativë; hartuan planin operativ; dhe përcaktuan gjithë hapat konkretë për implementimin e tij. Në këtë ndërmarrje famëkeqe u thirrën policët fizikisht më të fuqishëm e më të pamëshirshëm. Ata i kishin duart e lira të bënin ç'të donin me popullsinë e akuzuar shqiptare.

Pasi u mor pëlqimi edhe i klasës politike në nivel komune, aksioni filloi në Gjakovë e në fshatrat rreth saj. Fillimisht u organizuan mbledhje me shqiptarët për dorëzimin e armëve, që u shoqëruan menjëherë me kontrollet e bastisjet nëpër shtëpi. Në stacionet e policisë u thirrën shqiptarët më markantë (të njohur), prej të cilëve është kërkuar të dorëzohet armët. Ata që kanë kundërshtuar janë keqtrajtuar, disa më shumë e disa më pak. Ky ishte momenti paralajmërues për të frikësuar të tjerët që të kuptonin se nuk mund të fshihnin armët.

Më pas filloi aksioni masiv, ku u kërkuar domosdoshmërisht nga të gjithë meshkujt e zonës që të dorëzonin armën që mbante gjithsecili. Në fshatin Brekoc janë thirrur 20 persona, prej tyre,

9 janë rrahur deri në humbje të vetëdijes dhe vetëm 3 vetë e kanë dorëzuar armën. Njerëzit thirreshin shumë herë, i linin tërë natën e ditën në borë dhe në të ftohtë si shenjë presioni. Ndonjëri thirrej disa herë, çdo ditë, çdo të dytën apo të tretën ditë. Ka qenë praktikë e zakonshme që njeriu të vijë në mëngjes, të qëndrojë deri në mbrëmje, e askush të mos bisedojë me të dhe në fund i thoshin: “Shko, eja nesër dhe sille pushkën” (AHRGj 3). Të nesërmen e më pas keqtrajtimet varionin nga sharja më e ndyrë në fe, gjuhë e komb, rrahja me mjete më primitive, vendosja e telave të rrymës në vesh, mbajta me kokë poshtë duke i futur ujë në hundë, thyerja e dhëmbëve dhe këputja e gishtërinjve, lidhja për pemë si kafshë, sidomos për kumbulla, arra e molla, vrasja në mënyrë mizore dhe hudhja e kufomave në puse-bunare e shumë e shumë metoda të tjera çnjerëzore. Në këto tortura ndër më famëkeqët e komunës së Gjakovës janë dalluar stacioni policor i Cërmjanit, stacioni policor i Hereçit. Deklaratat e qytetarëve e provojnë këtë dhe akuzojnë autorët e dhunës: zyrtarët e SPB-së Bllagoje Stefanoviçi, Rade Baboviçi, Dragan Okileviçi, Mirko Iliçi, të cilët me bashkëpunëtorët e tyre kanë keqtrajtuar: Halil Mehmet Hazirin, Selim Hadrin nga Skivjani, Ukë Mirakajn nga Skivjani, vëllezërit Arif Musli Ademaj dhe Islam Musli Ademaj nga Skivjani, Ukë Jusufi nga Hereçi, Zhuj Selmani dhe Sokol Kadrija nga Dujaka, Idriz Zogu nga Dubrava, Ibish Zeqa nga Gllgjani, Avdi Ibishi nga Juniku, Martin Nue Kola nga Novosella e Epërme, Kol Prenk Lleshaj nga Novosella e Epërme, Ismail Sadik Koka nga Janoshi, Prenç Marku nga Janoshi, Gjergj Marjakaj nga Novosella e Ultë, Gjin Tun Gjidoda nga Plançori. Një numër i madh i qytetarëve të cilët janë keqtrajtuar në këtë stacion policor i kanë dorëzuar armët, por nuk kanë dhënë dëshmi. Midis tyre po përmendim: Malë Asllan Dinaj, Asmon Hadri, Idriz Jakupi nga Skivjani; Lan Halil Islamaj, Zog Rrustemi nga Dujaka e shumë të tjerë.

Në kullën e Bajram Nezës nga Skivjani në vitin 1956 UDB-ja zbuloi në mes të murit të shkallëve të jashtme bunkerin për armatim. U mor pushkëmitralozi, manxerrja e gjatë dhe pushka

me dylbi me ç’rast u arrestuan i biri i Bajram Nezës-Mala (dënohet me dy vjet burg dhe gjobë) dhe nipi i tij Hysen Neza, i cili dënohet me 6 muaj burg (Dinaj 2010: 151).

Edhe në fshatrat tjera është përdorur dhuna kundër një numri të madh njerëzish, sepse nuk i dorëzonin armët, të cilat sipas organeve të punëve të brendshme i posedonin. Organet thoshin se çdo burrë posedon armë dhe duhet ta dorëzojë.

Nga Bllagoje Stefanoviçi dhe Rade Baboviçi në bazë të dëshmimeve arkivore janë keqtrajtuar mizorisht shumë banorë (kishte edhe raste të vdekjes). Ndër të keqtrajtuarit janë: Fran Kolë Nikollbibaj nga fshati Brekoc, Ded Pren Nikolla nga fshati Dol, Mark Dushi nga Kushaveci-Bishtazhin, Ndrec Mikel Noci nga Doli, Mhill Simon Gjokaj nga Kusari (më pas i vdekur), Zef Beka nga Meja (i vvarë), Palush Lushi nga Guska, Palush Gjon Prenqi nga Ujzi, Ibrahim Alija nga Morina, Haxhi Beqa nga Shishmani, Shani Hoxha nga Gjakova e shumë të tjerë.

Nga Dragan Okileviçi që ishte operativist në territorin: Junik, Batushë, Nivokaz, Dobrosh janë keqtrajtuar mizorisht: Ukë Tahiri nga Nivokazi, Bajram Dani nga Batusha e shumë të tjerë.

Në këtë atmosferë, për t’u shpëtuar torturave, në disa fshatra si në Dol, Bishtazhin, Ujz banorët e tyre i grumbullonin armët që posedonin dhe i dorëzonin në mënyrë vullnetare. E megjithatë ata përsëri u thirrën në polici për të dorëzuar armë të tjera. Ishte kthyer në ligjësi që qytetarët, të cilët nuk kishin më armë, duhej patjetër të gjenin e t’i dorëzonin, përndryshe fillonte keqtrajtimi deri te gjymtimi, apo dhe vdekja. Ndoshte shpesh që shqiptarët i blenin armët në fshatrat përreth, shpesh të banuara nga serbë. Çmimi i tyre as që vihej në balancë përballë shpëtimit të jetës. Ky fenomen solli si pasojë zgjerimin e aksionit me një intensitet të rritur edhe në fshatrat e tjerë. Meqë ky fenomen ishte i përhapur në të gjithë Kosovën, Vojin Llukiç, sekretar i atëhershëm i SPM të Republikës së Serbisë me telegramin e datës 22 shkurt 1956 urdhëron që aksioni të zgjerohet edhe në territoret fqinje të ish rretheve të Vranjës, Leskocit, Prokupjes, Krushecit e Novi Pazarit. Por jo rallë, në procesin e shit-blerjes së

armëve ishin përfshirë vetë punonjësit e Sigurimit që kërkonin ryshfet.

Në qëndrimin e organeve të Sigurimit shtetëror në Gjakovë e gjithashtu në Kosovë, mendoj se duhet përmendur edhe presioni i tyre ndaj shërbimit shëndetësor për të mos u marrë me shërimin e personave, të cilët janë keqtrajtuar gjatë aksionit. Mjekët e Gjakovës nuk u lejuan të japin çertifikata për lëndimet e qytetarëve, apo për vdekjen e tyre për shkak të rrahjeve.

Qëndrimi brutal e sarkastik i pushtetit shkante akoma më larg ndaj qytetarëve të Kosovës. Këta të fundit, nëse tentonin të bënin ndonjë ankesë, ndodheshin jo vetëm përballë kërcënimeve të Sigurimit të shtetit, por edhe përballë veshit të shurdhër të administratës së kohës, e cila ishte tërësisht nën kontrollin e Sigurimit dhe nuk lejohej të merrej me ankesat e qytetarëve për veprimet e paligjshme dhe jonjerëzore të ushtruara ndaj tyre në dimrin e 1955-1956.

Edhe nëse ka ndodhur që ndonjë punonjësi i SPM, ka kundërshtuar masat e urdhëruara nga eprorët e tij për aksionin e mbledhjes së armëve në Kosovë, ndaj tij janë marrë masa të menjëhershme disiplinore, transferim në ndonjë vend tjetër, pensionim, deri te largimi nga puna. Ndërkohë, policët të cilët janë dalluar për zullumin e ushtruar ndaj shqiptarëve, pas mbarimit të aksionit të mbledhjes së armëve janë shpërblyer nga Sekretariati Republikan i punëve të brendshme me poste më të larta dhe të holla. Kjo dukuri ka qenë mjaft e dukshme në territorin e rrethit të Pejës dhe në atë të Gjakovës.

Pasojat

Pavarësisht nga praktikat e dhunshme organet e Sigurimit në Gjakovë e në rrethinat e saj arritën të mbledhin vetëm “360 pushkë, 1 mitraloz, 148 kobure, 5 automatikë, 208 bomba, 130 revole, 2 raketa të kobureve dhe 9535 plumba” (AHRGJ 4). Këto rezultate, në vështrimin fizik ishin të pakënaqshme për organet e larta të Sigurimit, por edhe për organet vartëse të Gjakovës. Në raportet e SPB të Gjakovës vërehen pohime të tilla si: “Kemi ushtruar presion, por pa sukses. Kishte edhe raste të rënda të përdorimit të dhunës, por nuk kemi mundur të marrim më shumë armë” (AHRGJ 2).

Ndërkohë, këto organe ishin shumë të kënaqura për rezultatet politike të Aksionit të mbledhjes së armëve. “Zbulimi dhe marrja e armëve kanë dhënë rezultate shumë të mira, shkruhej në një raport të organeve të Sigurimit të KAKM. Kryeneçësia, besimi dhe mundësia e rezistencës ndaj pushtetit ka ra në minimum /.../. Organizatat e Lidhjes së Komunistëve janë pastruar mjaft, pasi duke u angazhuar në këtë aksion janë bërë më të forta dhe janë lidhur më tepër me politikën e Lidhjes së Komunistëve. Ky aksion është shfrytëzuar edhe për krijimin e rrjetit tonë të kualitetshëm (cilësor)” (AHRGJ: Raport i Komisionit).

Në vitin 1966 kur J. B. Titos i nevojiteshin shqiptarët t'i kishte në krah përballë Rankoviçit, rivalit të tij kryesor politik, shqiptarët përjetuan një rilindje të re, por që nuk vazhdoi gjatë. Një Komision Shtetëror Komunal për territorin e komunës së Gjakovës i ngritur për të evidencuar deformimet e keqpërdorimit, në bazë të vendimeve të plenumit të IV të KQ të LKJ dhe vendimeve të Plenumit të VI të LKS, u njoh me 310 deklarata të qytetarëve (prej të cilave 287 të nënshkruara dhe 23 anonime) të komunës së Gjakovës dhe 19 nëpunës të Sigurimit të Shtetit u vunë nën akuzë. Por rezultatet ishin të pamjaftueshme si për arsye teknike e përvoja, ashtu edhe për shkak të ndërhyrjeve të nëndheshme politike. Gjithsesi, pavarësisht nga kufizimet u arrit të evidentohen hapur një varg shkeljesh e deformimesh në veprimtarinë e organeve të Sigurimit ndaj shqiptarëve të Kosovës.

Përfundimi

Që në fillim më duhet të theksoj se përmasat që pati Aksioni i mbledhjes së armëve në Kosovë, si dhe dëmet që solli ai ndaj popullsisë shqiptare, nuk mund të krahasohen me asnjë rajon dhe me asnjë popullsi tjetër në ish – Federatën Jugosllave. Në këtë ekspeditë ndëshkimore u keqtrajtuuan mbi 30.000 shqiptarë, vdiqën nga rrahjet dhe torturat 103 prej tyre dhe u gjymtuan për jetë rreth 10.000 të tjerë. Në këtë aksion ishte gërshetuar dhuna etnike me dhunën komuniste.

Megjithëse Federata jugosllave konsiderohej një vend komunist liberal në konceptin e viteve '50, e vërteta është se shkelja e të drejtave njerëzore dhe kushtetuese të qytetarëve ishte drastike ndaj shqiptarëve. Lëndimet e dhunshme fizike, vdekja e qytetarëve të pafajshëm për shkak të ushtrimit të dhunës, apo vetëvrasja si pamundësi jetese normale, ishin tipare esenciale të këtij aksioni. Statistikat e largimeve të shqiptarëve nga Kosova për vitin 1956 dhe 1957, zënë vendin e parë në klasifikim për nga numri i tyre në dhjetë vjeçarim mes viteve 1955-1965. Kjo flet qartë për pasigurinë e jetës së tyre në Kosovë.

Shqiptarët u ndjenë të dhunuar nga Aksioni i mbledhjes së armëve dhe në memorien e tyre kolektive do të jetojë gjatë dhimbja për familjarët e afërm dhe dhimbja për bashkëkombasit, me të cilët ndanin një identitet kombëtar, një mënyrë të sjelluri dhe një dashuri të madhe e të patjetërsueshme për Kosovën. Është kjo memorije e gjatë, e cila mbijetoi deri në fillim të shekullit të ri (XXI), duke i dhënë impuls përpjekjeve diplomatike dhe të armatosura të shqiptarëve për shkëputje nga Serbia dhe për krijim të shtetit të pavarur.

Bibliografia

I. Burime arkivore

Agjensioni Shtetëror i Arkivave të Kosovës

Fondet:

a) Fondi-Sekretarijat OK PK SK Kosova od 1966-1967 g., fascila broj 121, Kutia nr.15, dosja nr.18,

b) Fondi-Sekretarijat OK PK SK Kosova od 1966-1967 g., fascila broj 121, Kutia nr.15, dosja nr.19.

Arkivi Historik Regjional i Gjakovës:

a) fondi 88, Kutia Arkivore Nr. I, (material intern), 1966

b) fondi 88, Kutia Arkivore Nr. I, 1967

c) fondi 88, Kutia Arkivore Nr. 1 dhe Nr. 4, Depot e Arkivit, viti 1964-1967.

BAJRAMI, Hakif (1996), *Dëbimi dhe shpërngulja e shqiptarëve në Turqi* (dokumente), Prishtinë.

BAKALLI, Emine (1995), Konventa jugosllavo-turke për shpërngulje /.../: *Gjenocidi dhe aktet gjenocidiale të të pushtetit serb ndaj shqiptarëve*, ASHAK, Prishtinë.

BYTYQI, Abdullah (2001), *Terrori shtetëror serbo-malazias në Kosovë 1878-1991*, Prishtinë.

DINAJ, Shefqet (2010), *Skivjani-Historiku dhe trashëgimia kulturore*, Lidhja e historianëve të Kosovës "Ali Hadri", Prishtinë.

GRUP autorësh (2008), *Historia e Popullit Shqiptar IV*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve, Tiranë.

HOTI, Ukshin (1995), *Filozofia politike e çështjes shqiptare*, Rozafa, Tiranë.

LALAJ, Ana (2000), *Kosova- rruga e gjatë drejtë vetëvendosjes 1948-1981*, Mësonjtorja e Parë, Tiranë.

Shtypi i kohës:

Rilindja 1955-1956, 1965-1990

Intervistat:

- Koshi, Xhevat, Gjakovë 2009
- Haziri, Smajl, Gjakovë 2010
- Gashaj, Halil, Osek Hylë 2010
- Meka, Miki, Kralan 2010
- Nikaj, Mhill, Ramoc 2010
- Sylja, Goqi, Rama, Sahiti, Beqa, familjarët Molliq 2010
- Nezaj, Asmon, Skivjan 2009.